INSTITUTI ISLAM IKRA
اقرأ

SEMESTRI I I DYTE

VIRTYTET E TË DËRGUARIT ﷺ



TETOVE 2020

HYRJE

Personaliteti i Muhammedit, salallahu alejhi ue selem, jeta dhe vepra e tij, që tek myslimanët, janë bazë e vizionit Islam për botën, kanë nevojë për promovim më të gjerë. Për këtë njeri i cili ndryshoi rrjedhën e historisë, që udhëzoi një popull të lajthitur dhe që edhe sot vazhdon të ndikon në jetën e shumë njerëzve, duhet të flitet. Këto hadithe janë bazë për njërën nga temat e historisë se hershme Islame (Es-Sire En-Nebevijje), e ajo është *esh-Shemail* - përshkrimi i pamjes së jashtme, sjelljes dhe moralit të Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem.

Njëri nga komentuesit e shumtë të këtij libër Abdur- Reuf El Munavi thotë: "Ky libër ësht i veçuar në lëminë e tij, dallohet për nga përfshirja e plotë të haditheve që flasin për këtë temë dhe nga radhitja tyre. Askush nuk ka përpiluar libër të ngjashëm. Gjatë përpilimit autori ndjek një metodë të jashtëzakonshme duke e zbukuruar me hadithe në mënyrë artistike ashtu që ky libër me të drejtë konsiderohet prej dhuntive hyjnore. Ky libër u përhap në lindje dhe perëndim…"

Muhammed Nasiruddin Albani thotë: "Shpresoj se ky libër do të bëhet udhëzue për muslimanët nëpërmjet të cilit ata do t'i njohin virtytet e larta të Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, si dhe do t'i motivon që ta ndjekin rrugën e tij, duke zbukuruar vetën me moralin e Tij në këtë kohë kur shumë njerëz e kanë harrua porosinë e të Lartësuarit i cili thotë: ***"Ju e kishit shembullin më të lartë në t Dërguarin e Allahut, kuptohet ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botë tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh Allahun"***. (El Ahzabë, 21).

Botimi që gjendet në duart e juaja është përkthim i versionit të shkurtuar të këtij libri me vlerësimet për vërtetësinë e haditheve të dijetarit të njohur shqiptar Nasiruddin Albani i cili botoi këtë libër duke e shkurtuar atë dhe duke dhënë vlerësimin e tij për çdo hadith në bazë të parimeve të shkencës së hadithit. Nga veçoritë e këtij botimi është edhe tubimi i gjitha transmetimeve në një vend dhe pastaj vlerësimi i hadithit, ngase pa këtë nuk do mundej të vlerësohet hadithi në mënyrë të duhur. [1]

Për këtë skriptë janë përzgjedhur vetëm hadithet që Shejh Albani i ka cilësuar si *Sahih* apo *Hasen* dhe nuk ka hadithe që janë cilësuar si të dobët. Janë zgjedhur një pjesë e haditheve të botimit të njohur me qëllim që ti përshtatet planprogramit të Institutit.

[1] Pjesë nga hyrja e librit Virtytet e të Dërguarit të botuar nga shtëpia botuese Nun-Shkup. Hadithet e kësaj skripte janë marrur nga versioni PDF i këtij libri, **i veçantë për Institutin Islam Ikra**, me disa ndryshime tepër të vogla të cilat janë bërë për dobinë e nxënësit.

SI DUKEJ I DËRGUARI

1. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu tregonte: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem nuk ishte as i lartë (i gjatë) e as i ulët, as dukshëm i bardhë e as zeshkan, nuk kishte as flokë kaçurrela e as të drejta. Allahu e zgjodhi për pejgamber kur i kishte dyzet vjet. Në Mekke kaloi trembëdhjetë vjet, kurse në Medine dhjetë vjet. Vdiq kur i pati gjashtëdhjetë e tre vjet, kurse flokët dhe mjekra e tij nuk kishin as njëzet qime të thinjura.” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

2. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregonte: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte shtat të mesëm, nuk ishte as i lartë e as i ulët, me shtat të bukur. Nuk kishte as flokë kaçurrela e as të drejta, ishte zeshkan, kur ecte shpejtonte.” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Nesai)

3. El-Bera Ibën Azibi, radijallahu anhu, transmeton: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte shtat të mesëm, ishte i gjërë mes shpatullave, flokët i binin deri në skajet e veshëve, i veshur në xhybe (hulle) të kuqe. Asnjëherë nuk kam parë dikë më të bukur se atë.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Maxhe)

4. Ali Ibën Ebi Talibi, radijallahu anhu, transmeton: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, nuk ishte as i lartë e as i ulët, kishte shuplaka dhe shputa të vrazhda, kokë të madhe dhe eshtra të mëdhenj, qime më të gjata në gjoks. Kur ecte, ecte shpejtë sikur zbriste kodrës. Asnjëherë, as më parë e as më vonë, nuk kam parë dikë të ngjashëm me të.” (Transmeton Tirmidhi në Menakib)

5. Xhabir Ibën Semure, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut ishte buzëplotë, symadh, kishte thembra të vogla.” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

6. Xhabir Ibën Semure, radijallahu anhu, tregon: “Një natë të ndritshme pashë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, të veshur me xhybe të kuqe. Shikova atë e pastaj edhe hënën. Për mua ai ishte më i bukur se hëna.” (Transmeton Tirmidhi).

7. Ebu Is'haku rrëfen se një njeri e ka pyetur El-Bera Ibën Azibin, radijallahu anhu: "A shkëlqente fytyra e Resulullahut si shpatë? Jo, u përgjigj: Përkundrazi, shkëlqente si hëna." (Transmetojnë Buhari, Tirmidhi dhe Ahmed)

8. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ishte lëkurëbardhë sikur ishte shkrirë prej argjendi, kishte flokë pak si të valëzuara." (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

VULA E PEJGAMBERISË

9. Saib Ibën Jezidi, radijallahu anhu, tregon: “Vajta me tezën tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, dhe (tezja) i tha: - O i Dërguari i Allahut, nipi im është i sëmurë! I Dërguari i Allahut ma ledhatoi kokën, luti Allahun të më bekojë e pastaj mori abdest. Unë piva ujë nga ena me të cilën kishte marrë abdest, qëndrova pas tij dhe fillova t'ia shikoj vulën e pejgamberisë që e kishte ndërmjet shpatullave, që ishte sa një vezë shkurtëze." (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

10. Xhabir Ibën Semure tregon: “E pash vulën e pejgamberisë ndërmjet të dy shpatullave, dukej si gjëndër e kuqe në madhësi të vezës së pëllumbeshës.” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

11. Ebu Zejd Amër Ibën Ahtab El-Ensari, radijallahu anhu, transmeton: “Me një rast i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, më tha: O Ebu Zejd, afrohu dhe fërkoma shpinën time. Kur ia vura dorën në shpinë, nën gishtat e mi e ndjeva vulën e pejgamberisë. E pyeta: - Si dukej vula? - Disa qime të mbledhura, u përgjigj.” (Transmetojnë Ahmed, Ibën Sa’d, Ibën Hibban dhe Hakim)

12. Ebu Se'id el-Hudri, radijallahu anhu, tregon: "Vula e pejgamberisë ishte copë mishi, e dalluar (si gungë)." (Transmeton Tirmidhi)

13. Abdullah Ibën Serxhisi, radijallahu anhu, tregon: "Me një rast erdha tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, derisa rrinte ulur me as'habët dhe unë kështu (dhe e tregoi mënyrën) i shkova pas shpine. Ai hetoi qëlli min tim dhe largoi pelerinën që kishte mbi supet. Atëherë e pashë vulën e pejgamberisë ndërmjet shpatullave, dukej si grusht i mbledhur rreth të cilit ishin pikëza të zeza si çibanë. Pastaj u ngrita përpara tij dhe i thashë: Allahu të faltë, o i Dërguari i Allahut! Tha: Edhe ty. - A kërkoi i Dërguari i Allahut falje për ty? - e pyetën të pranishmit Abdullahun. -Po, edhe për ju ka kërkuar falje. Dhe Abdullahu lexoi ajetin: '… kërko falje për mëkatin tënd, për të besimtarëve e të besimtareve…' (Muhammed: 19)" (Transmetojnë Muslim dhe Ahmed)

FLOKËT E TË DËRGUARIT

14. Enes Ibën Maliku, radijAllahu anhu, transmeton: “Flokët e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, binin deri në mes të veshëve.” (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Maxhe)

15. Aishja, radijallahu anha, transmeton: “Lahesha me të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, prej një enë, kurse flokët e tij nuk ishin as të shkurtra e as të gjata.” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

16. Ummu Hani, radijAllahu anha, tregon: “Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, e çliroi Mekken, hyri në të ndërsa flokët i kishte të gërshetuar në katër gërshetë.” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, Ibën Maxhe dhe Ahmed)

17. Ibën Abbasi, radijAllahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte flokë të gjata të cilat i lëshonte pa u bërë vijë. Mushrikët u bënin vijë flokëve në mes të kokës, kurse ithtarët e Librit (çifutët dhe krishterët) flokët lëshonin që të bijnë lirisht. I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, parapëlqente pasimin e ithtarëve të Librit në gjërat për të cilat nuk kishte urdhër të prerë, kurse më vonë filloi të bëjë vijë të flokëve (t’i ndajë përgjysmë).” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai, Ibën Maxhe dhe Ahmed)

SI I KREHTE FLOKËT

18. Aishja, radijAllahu anha, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, në gjithçka i pëlqente të fillojë nga ana e djathtë: gjatë larjes, gjatë krehjes së flokëve dhe gjatë mbathjes së këpucëve.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

19. Abdullah Ibën Mugaffel, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka ndaluar krehjen e flokëve përpos kohë pas kohe (më rrallë). (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Hibban)

QIMET E THINJURA

20. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Nuk kam numëruar në flokët dhe mjekrën e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, më shumë se katërmbëdhjetë qime të bardha.” (Transmetojnë Buhari dhe Ibën Maxhe)

21. Xhabir Ibën Semure, radijallahu anhu, tregon: Në vijën që ndante flokët e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, kishte disa qime të thinjura, të cilat i fshehte vaji kur lyente flokët me vaj.” (Transmetojnë Muslim dhe Nesai)

22. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “Me një rast pyeti Ebu Bekri: O i Dërguari i Allahut, shoh se je thinjur? Më thinjën suret Hud, Vakia, Murselat, Amme dhe Idhesh-shemsu kuvviret.” (Transmeton Tirmidhi dhe Hakim)

I DËRGUARI I LYENTE FLOKËT ME KËNA

23. Uthman Ibën Meuhibi tregon: “Është pyetur Ebu Hurejra, radijallahu anhu, a i ka lyer i Dërguari i Allahut me këna, u përgjigj: “Po”. (Transmetojnë Buhari, Ahmed dhe Ibën Maxhe)

24. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “I pash flokët e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, të lyera me këna.” (Transmeton Tirmidhi)

SYRMEJA

25. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Tërhiqne syrmen me ithmid, sepse ai mpreh të pamurit dhe forcon qerpikët." (Transmetojnë Ibën Maxhe dhe Nesai dhe hadithi i njëjtë është transmetuar prej Xhabirit, Ibën Abbasit dhe Ibën Omerit, radijallahu anhum)

VESHJA E TË DËRGUARIT

26. Ummu Seleme, radijallahu anhu, tregonte: “Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut ishte kamisi.” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

27. Ebu Se’id Hudriu, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut kur vishte rrobe të reja, qoftë imame, kamis apo rida, i emërtonte dhe lexonte këtë dua: "-O Allahu im! Ty të takon falënderimi që më veshe me këtë veshje (dhe e përmendte me emër). Të lutem për të mirën e saj dhe për të mirën për çka është qepur, kurse mbështetem te Ti nga e keqja e saj dhe e keqja për çka është qepur.” (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi)

28. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, na tregon: “Veshja më e dashur e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, ishte xhybeja e Jemenit.” (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

29. Ebu Xhuhejfe, radijallahu anhu, tregon: “Pashë të Dërguarin e Allahut të veshur me xhybe të kuqe, sikur tani jam duke e parë shkëlqimin e kërcirit të tij. Sufjani, njëri prej transmetuesve, thotë: Më duket se ishte xhybe e Jemenit” (Transmeton Buhari)

30. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Vishni rrobe të bardha. Le ti veshin të gjallët, dhe me to mbështillni të vdekurit, sepse ato janë rrobat më të mira.” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

31. Urvete Ibën Mugire Ibën Shu’be, radijallahu anhum, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, me një rast veshi një xhybe bizantine me krahë (mëngë) të ngushtë.” (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

MBI MESTET E TË DËRGUARIT

32. Burejde, radijallahu anhu, tregon: “Nexhashiu i dhuroi të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, meste krejtësisht të zeza dhe pa zbukurime, e ai i mbathi, mori abdes dhe i fërkoi ato (u dha mes’h).” (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

"KËPUCËT" E TË DËRGUARIT

33. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte këpucë me dy rripa të kthyer.” (Transmeton Ibën Maxhe)

34. Isa Ibën Tahmani, rahimehullah, tregon: Enesi, radijallahu anhu, nxori para neve sandale prej lëkurës së regjur (pa qime) me dy rripa. Më vonë Thabiti më tha, ata ishin sandalet e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem. (Transmetojnë Buhari dhe Ibën Maxhe)

35. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Kur të mbathni këpucët, së pari mbathni këmbën e djathtë, kurse kur të zbathni së pari zbathni të majtën. Këmba e djathtë le të jetë e para që mbathet, kurse e fundit që zbathet.” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

UNAZA E TË DËRGUARIT

36. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Unaza e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, ishte prej argjendi, kurse guri i tij nga Abisinia.” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud, Ibën Maxhe, Tirmidhi dhe Nesai)

37. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Kur me urdhër të të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, janë shkruar letrat për perandorin e Persisë, Bizantit dhe Abisinisë, i është thënë: - Perandorët nuk pranojnë letra pa vulë. Atëherë iu punua unazë prej argjendit në të cilën ishte i gdhendur teksti: Muhammedun resulullah.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Nesai dhe Ebu Davud)

38. Ibën Omeri, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka mbajtur unazë prej argjendit, pastaj atë e trashëgoi Ebu Bekri, pastaj Omeri. Kur e trashëgoi Othmani i ra nga dora në pusin Eris. Në unazë shkruante: Muhammedun Resulullah - Muhammedi, i Dërguari i Allahut.” (Transmetojnë Buhari, Nesai dhe Ebu Davud)

I DËRGUARI, UNAZËN E MBANTE NË DORËN E DJATHTË

39. Ali Ibën Ebi Talibi, radijallahu anhu, rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, unazën e mbante në dorën e djathtë.” (Transmetojnë Ebu Davudi dhe Nesai)

40. Xha’fer Ibën Muhammedi, rahimehullah, prej të atit të tij na e ka përcjellur këtë gojëdhënë: “Hasani dhe Husejni, radijallahu anhuma, mbanin unazat në dorën e majtë.” (Transmeton Tirmidhi)

SHPATA

41. Enesi, radijallahu anhu, rrëfen: “Kapëza e shpatës së të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, ishte prej argjendit.” (Transmeton Ebu Davudi, Nesai dhe Tirmidhi)

MBUROJA

42. Zubejr Ibën Avvami, radijallahu anhu, tregon: “Në ditën e betejës së Uhudit, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka veshur dy mburoja (prazmore). Kur tentoi të ngjitet në një shkëmb, nuk mundi. U mbështet për Talhanë i cili u ul poshtë tij, e ai u ngjit në shkëmb. Atëherë e dëgjova si thotë: Talha meritoi Xhennetin!” (Transmeton Tirmidhi)

SARËKU (I'mame-ja)

43. Amër Ibën Hurejthi, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, mbante hutbe me sarëk të zi në kokë”. (Transmetojnë Muslimi, Ibën Maxhe dhe Ebu Davud)

44. Ibën Omeri, radijallahu anhuma, tregon: “Kur i Dërguari i Allahut e lidhte sarëkun, njërin skaj e lëshonte mes shpatullave.” (Transmeton Tirmidhi)

IZARI

45. Ebu Burdete, radijAllahu anhu, rrëfen: “Aishjana e nxori një mbulesë të trashe dhe të arnuar dhe një izarprej stofit së vrazhdët dhe thoshte: I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, dha shpirt në këtë veshje.” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

46. Hudhejfe Ibën Jemani, radijallahu anhu,rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kapi pulpën e kërcës së vet ose timen (dyshon transmetuesi) dhe më tha: Ky është vendi ku duhet të përfundojë gjatësia e izarit dhe mund ta zgjasësh deri te kyçi i këmbës dhe nuk lejohet zgjatja ndër të (kyçin e këmbës)”. (Transmeton Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

SI ULEJ I DËRGUARI

47. Abdullah Ibën Jezidi, radijallahu anhu, tregon: Pashë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, se si ulet i mbështetur në xhami duke vënë njërën këmbë mbi tjetrën.” (Transmetojnë Buhari, Muslimi, Ebu Davud dhe Nesai)

48. Ebu Se’id Hudriu, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kur ulej në xhami, me duar i bashkonte këmbët për gjoksi.” (Transmetojnë Ebu Davudi dhe Bejhakiu)

49. Xhabir Ibën Semure, radijallahu anhu, rrëfen: “Pashë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, të ulur, ishte mbështetur në jastëk nga ana e majtë.” (Transmetojnë Ebu Davud dhe Tirmidhi)

SI JETONTE I DËRGUARI

50. Malik Ibën Dinari, rahimehullah, rrëfen: “I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, asnjëherë nuk është ngopur me bukë dhe mish, përveçse kur ulej me njerëz në gosti.” (Transmeton Tirmidhi)

51. Nu’man Ibën Beshiri, radijallahu anhu, u fliste miqve: “A nuk hani dhe pini atë që dëshironi? E di se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, nuk i ka pasur as hurmat më të këqija për ta mbushur barkun.” (Transmeton Tirmidhi dhe Muslim)

52. Aishja, radijallahu anha, rrëfen: “Ne, familja e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, kalonim një muaj të tërë pa ndezur zjarr. Jetonim nga hurmat dhe uji.” (Transmeton Buhari dhe Muslim).

53. Enesi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Në rrugë të Allahut shijova frikën kur të tjerët ishin në siguri, dhe pata mundime kur të tjerët nuk i kishin. Unë dhe Bilalli kaluam tridhjetë ditë, kurse ushqimi i vetëm që mund të hajë njeriu i gjallë ishte diç që mbante Bilali nën sjetull.” (Transmeton Tirmidhi)

SI HANTE I DËRGUARI

54. Ka'b Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, hante me tre gishta, e pastaj i lëpinte." (Transmetojnë Muslim dhe Ebu Davud)

ÇFARË BUKE HANTE I DËRGUARI

55. E kam dëgjuar Ebu Umame El Bahiliun të thotë: “Buka e elbit asnjëherë nuk tepronte në shtëpinë e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem.” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ahmedi)

56. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “Familja e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, me netë ngrysej e uritur. Nuk kishin ç'të hanin për darkë. Buka që më së shpeshti e hanin ishte buka e elbit.” (Transmeton Tirmidhi)

57. Dikush pyeti Sehl Ibën Sa’din, radijallahu anhu: “A ka ngrënë i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, bukë prej miellit të bardhë? - I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, as që ka parë miell të bardhë derisa nuk u shpërngul në Ahiret - u përgjigj Sehli. - A kishit sitë? Jo, nuk kishim. - E si e pastronit elbin? - Do të frynim në të e pastaj do ta gatuanim.” (Transmetojnë Buhari, Nesai, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

USHQIMI

58. Aishja, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Sa "ushqim" i mirë që është uthulla.” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

59. Aishja, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Sa mëlmesë e mirë që është uthulla.” (Transmetojnë Muslim dhe Tirmidhi)

60. Ebu Esidi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Hani vaj ulliri dhe lyeni flokët me të, sepse është prej drurit të bekuar.” (Transmeton Tirmidhi)

61. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Një rrobaqepës e thirri të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, për drekë, ku më mori edhe mua. Kur lëshoi përpara të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, bukën e elbit dhe çorbën prej kungujve të vegjël dhe mishit të thatë, pashë se si ai zgjedhte kungujt nga ena. Prej atëherë edhe unë i dua kungujt.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ebu Davud)

62. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: “I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i donte ëmbëlsirat dhe mjaltin.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

63. Abdullah Ibën Harithi, radijallahu anhu, tregon: “Me të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, në xhami hanim mish të pjekur.” (Transmeton Ibën Maxhe)

64. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon: “Të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, i sollën mish dhe ia ofruan kutin (e deles), sepse e dinin se Ai, salallahu alejhi ue selem, e pëlqen. I Dërguari i Allahu, salallahu alejhi ue selem, kafshoi një copë nga mishi i kutit.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

65. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Vlera e Aishes, radijallahu anha, mbi gratë tjera është sikur vlera e përsheshit ndaj ushqimeve tjera.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

66. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Për gostinë e dasmës me rastin e martesës me Safijen, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, solli hurma dhe ushqim prej miellit të mirë.” (Transmeton Tirmidhi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

67. Xhabiri, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, më mori me vete te një ensarije. Ajo na solli mish të pjekur prej deles që e theri për të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, pastaj hurma të freskëta. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, hëngri, mori abdest dhe shkoi të falë namazin e drekës. Kur u kthye përsëri, gruaja ia solli atë që kishte mbetur prej mishit të pjekur dhe ai vazhdoi të hajë. Pastaj shkoi të falë ikindinë pa e ripërtërirë abdestin.” (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Maxhe)

68. Aishja, radijallahu anha, rrëfen: “Ndonjëherë kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, hynte në shtëpi do të pyeste: A ka diçka për drekë? – Nuk ka - do të përgjigjesha. - Unë agjëroj - do të thoshte atëherë. Kur hyri një ditë, i thashë: Na është sjell dhuratë. - Çfarë dhurate? - më pyeti. - Hurma të shtypura me miell dhe gjalpë, u përgjigja. Sot jam gdhirë me nijet agjërimi. E pastaj hante, deklaroi ajo.” (Transmeton Tirmidhi)

69. Enesi, radijallahu anhu, tregon: “Të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, i pëlqente të hajë atë që mbetej prej ushqimit.” (Transmetojnë Ahmedi dhe Hakimi)

ABDESI I TË DËRGUARIT PARA DHE PAS USHQIMIT

70. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, rrëfen: “Kur i Dër-guari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, u kthye pas nevojës së kryer, i sollën ushqim dhe e pyetën: - A të të sjellim ujë për abdest? Më është urdhëruar që të marr abdest kur dua të falem.” (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud dhe Nesai)

ÇFARË THOSHTE I DËRGUARI PARA DHE PAS USHQIMIT

71. Aishja, radijallahu anha, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kur dikush harron që para ushqimit të përmend emrin e Allahut, kur të kujtohet atëherë le të thotë: Bismil-lahi evveluhu ve ahirehu- Me emrin e Allahut - në fillim dhe në mbarim." (Transmetojnë Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi)

72. Omer Ibën Ebi Seleme, radijallahu anhu, rrëfen se ka ardhur tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, pikërisht kur ai hante. - Ulu bir - më tha – thuaj bismil-lahin, ha me dorë të djathtë dhe ha para vetes." (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

73. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Allahu është i kënaqur me robin e vet që hanë një kafshatë ushqim apo pin një gllënjkë ujë dhe për atë e falënderon Allahun." (Transmetojnë Muslim, Nesai dhe Tirmidhi)

BARDAKU

74. Thabiti rrëfen: “Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, na tregoi një gotë të vrazhdët druri, të përforcuar me hekur dhe tha: O Thabit, kjo është gota e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem.” (Transmeton Buhari)

PEMËT

75. Abdullah Ibën Xha'feri, radijallahu anhu, rrëfen: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka ngrënë trangull me hurma të freskëta." (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

76. Aishja, radijallahu anha, tregon: "I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka ngrënë shalqi (pjepër) me hurma të freskëta." (Transmetojnë Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

ÇFARË PIJE PINTE I DËRGUARI

77. Aishja, radijallahu anha, rrëfen: “Pijet që më së shumti i donte i Dërguari i Allahut, salallahu alejhiue selem, ishin të ëmblat dhe të ftohtat.” (Transmeton Tirmidhi)

SI PINTE I DËRGUARI

78. Abdullah Ibën Amri, radijallahu anhu, rrëfen: “Pashë të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, pinte duke qëndruar në këmbë dhe i ulur.” (Transmeton Tirmidhi)

79. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, tregon: “I ofrova të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, ujë zem-zem, e Ai e piu derisa ishte në këmbë.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Nesai dhe Ibën Maxhe)

80. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, kur pinte ujë ndërpriste të pirit që të marrë frymë tre herë, e pastaj do të thoshte: - Kështu është më këndshëm dhe më mirë shuhet etja.” (Transmetojnë Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

I DËRGUARI E DONTE PARFUMIN

81. Enes ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte një enë të veçantë për parfum prej të cilës parfumosej.” (Transmeton Ebu Davud)

82. Ibën Omeri, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Tre gjëra të ofruara nuk është mirë të refuzohen: jastëket, parfumi dhe qumështi.” (Transmeton Tirmidhi)

SI FLISTE I DËRGUARI

83. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: “I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, nuk i recitonte fjalët shpejt sikur veproni ju. Të folurit e tij ishte i qartë, ndante fjalinë, saqë e mbante mend secili që ulej pranë tij.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud dhe Tirmidhi)

84. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, përsëriste fjalën tri herë që të jetë më i kuptueshëm.” (Transmetojnë Buhari dhe Tirmidhi)

TË QESHURIT

85. Abdullah Ibën Harithi, radijallahu anhu, tregon: “Askë nuk kam parë të buzëqesh më tepër se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem.” Në një transmetim tjetër thuhet: “Nuk qeshte me zë, por buzëqeshte.” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ahmedi)

86. Xherir Ibën Abdullahu, radijallahu anhu, tregon: “Që kur pranova Islamin I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, asnjëherë nuk më ndaloi të hyjë në shtëpinë e tij dhe nuk takohej me mua, e mos të buzëqeshej.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

87. Abdullah Ibën Mes’udi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “E di njeriun i cili i fundit do të dalë prej Xhehennemit. Do të dalë zvarrë, dhe do t’i thuhet: - Hyn në Xhennet! Ai do të niset për të hyrë dhe do të sheh se njerëzit më i kanë zënë vendet e veta, andaj do të kthehet dhe do të thotë: O Zot, njerëzit më i kanë zënë vendet e veta! - A të kujtohet koha (bota) që e ke përjetuar? - do të pyetet. - Më kujtohet - do të përgjigjet. Pastaj do t’i thuhet: - Dëshiro çfarë të duash! – dhe ai do të dëshirojë. Pastaj do t’i thuhet: - Të jepet ajo që dëshirove dhe dhjetë herë sa dynjaja. Po tallesh me mua, e Ti je Zot! - do të thotë njeriu. Atëherë pashë të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem, se qeshi dhe iu panë dhëmballët.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

SI MAHITEJ I DËRGUARI

88. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, në mahi i ka thënë: “O ti me dy veshë!” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Ebu Davud)

89. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, shoqërohej edhe me fëmijë. Njëherë i tha vëllait tim të vogël: - O Umejr, ç’bëri harabeli? [Çuni kishte harabelin në duar, me të cilin luante dhe i cili vdiq].” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai, Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

90. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon se i kanë thënë të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem: “O i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ti po mahitesh me ne? - Po, por unë flas vetëm të vërtetën - iu përgjigj ai.” (Transmeton Tirmidhi)

SI KA FJETUR I DËRGUARI

91. Berra Ibën Azibi, radijallahu anhu, rrëfen: “Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, shtrihej në shtrat, dorën e djathtë e vinte nën faqen e djathtë dhe lexonte: O Zot, më ruaj nga dënimi Ditën kur do t’i ngjallësh robërit Tu.” (Transmeton Tirmidhi)

92. Hudhejfe, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kur shtrihej në shtrat do të lexonte: O Allah, me emrin Tënd vdes dhe ngjallem. Kurse kur zgjohej lexonte: Falënderimi i takon Allahut, i Cili na ngjalli pasi që na mori jetën, dhe para tij do të ringjallemi.” (Transmetojnë Tirmidhi, Buhari, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

94. Aisheja, radijallahu anha, tregon: “Çdo natë, kur shtrihej, i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, do t’i bashkonte duart, dhe pastaj në duar do lexonte kul huvAllahu ehad-in, kul eudhu bi rrabbil-felek-un dhe kul eudhu bi rrabbin-nas-in. pastaj me duar do të fërkonte tërë trupin, fillonte me kokën, fytyrën dhe pjesën e përparme të trupit. Kështu vepronte tri herë.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi, Ibën Maxhe dhe Ebu Davud)

IBADETI

95. Mugire Ibën Shu'be, radijallahu anhu, tregonte: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, falej derisa nuk i ënjteshin këmbët. Kur e pyeste ndokush: - O i Dërguari i Allahut, përse ngarkohesh aq shumë, kur Allahu t'i ka falur të gjitha mëkatet e mëparshme dhe ato më pasme? - ai do të përgjigjej: - Si të mos jam rob falënderues!" (Transmetojnë Buhari, Muslim, Nesai dhe Ibën Maxhe)

96. Esved Ibën Jezidi tregon se ka pyetur Aishen, radijallahu anha: "Si e falte namazin e natës i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem? Tha: Pjesën e parë të natës e kalonte në gjumë. E në kohë të syfyrit e falte vitrin, e pastaj u kthente në shtrat. E nëse dëshironte i afrohej gruas së vet (për marrëdhënie intime). Kur e dëgjonte ezani ngrihej dhe, nëse të ishte xhunub do të lahej, e nëse jo, atëherë do merrte abdes dhe do të shkonte në xhami." (Transmetojnë Tirmidhi, Muslim, Nesai dhe Buhari)

97. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, rrëfen: "I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, natën falte trembëdhjetë rekate." (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

98. Aisheja, radijallahu anha, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, tërë natën e ka kaluar duke lexuar vetëm një ajet në namaz.” (Transmeton Tirmidhi në Shemail)

99. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: “Ndonjëherë i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, falej ulur. Kur i mbetnin edhe tridhjetë apo dyzet ajete, do të çohej për t'i lexuar në këmbë. Pastaj bënte ruku dhe sexhde, dhe ashtu do të falte edhe rekatin tjetër.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi, Nesai dhe Ibën Maxhe)

SI E FALTE NAMAZIN DUHA I DËRGUARI

100. Muadheja, rahimehAllah, tregon: “E pyeta Aishen, radijallahu anha, a ka falur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, namaz pas daljes së diellit (salatud-duha)? Po, u përgjigj, i falte katër rekate dhe më tepër se katër.” (Transmetojnë Muslim dhe Ibën Maxhe)

101. Abdurrahman Ibën Ebi Lejla tregon: “Vetëm Ummi Hani, radijallahu anha, më ka treguar se e ka parë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, duke u falur në kohën e duhasë. Ajo më ka thënë: Ditën kur u çlirua Mekka, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, hyri në shtëpinë time, u la dhe i fali tetë rekate. Asnjëherë nuk ka falur më shpejtë, por ka plotësuar rukunë dhe sexhdenë.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Maxhe)

TË FALURIT E NAFILEVE NË SHTËPI

102. Abdullah Ibën Sa'di, radijallahu anhu, tregon: "Pyeta të Dërguarin, salallahu alejhi ue selem: Cili namaz është më i mirë, në shtëpi apo në xhami? - A e sheh sa afër xhamisë është shtëpia ime, por më e dashur për mua është që të falem në shtëpi se sa në xhami, përveç farzit." (Transmeton Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

AGJËRIMI I TË DËRGUARIT

103. Abdullah Ibën Shekiku tregon se e ka pyetur Aishen, radijallahu anha, për agjërimin e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, me ç'rast ajo i është përgjigjur: "Agjëronte aq gjatë sa që mendonim se do të agjërojë përherë, dhe ndonjëherë ndërpriste agjërimin, saqë mendonim: nuk do të agjërojë kurrë. Qëkur erdhi në Medine, i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, asnjëherë nuk ka agjëruar tërë muajin, përveçse muajin ramazan." (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud, Muslim dhe Nesai)

104. Aisheja, radijallahu anha, tregon: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kishte kujdes që të mos i kalojnë ditët e hënë dhe e enjte pa i agjëruar." (Transmetojnë Tirmidhi, Nesai dhe Ibën Maxhe)

105. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Allahut i shfaqen veprat e njerëzve të hënën dhe të enjten, prandaj dëshiroj që veprat e mia t'i paraqiten duke qenë me agjërim." (Transmeton Tirmidhi)

106. Aisheja dhe Ummu Seleme, radijallahu anhuma, tregojnë: "Nga veprat më të dashura për të Dërguarin e Allahut ishte vepra të cilën njeriu e kryen vazhdimisht, edhe nëse është pak." (Transmeton Tirmidhi)

SI LEXONTE KURAN I DËRGUARI

107. Katadeja, rahimehullah, tregon se e ka pyetur Enesin, radijallahu anhu, për leximin e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, e ai u përgjigj: "E zgjaste leximin e tij." (Transmetojnë Buhari, Ebu Davud, Nesai dhe Ibën Maxhe)

108. Ummu Seleme, radijallahu anha, përshkruante: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ndalej në fund të çdo ajeti. Do të lexonte: EL-HAMDULILLAHI RABBIL-ALEMIN, e do të ndalej. Pastaj: ERRAHMANIR- RAHIM, e do të ndalej, dhe lexonte MELIKI JEUMID-DIN." (Transmetojnë Tirmidhi, Ebu Davud dhe Nesai)

TË QAJTURIT GJATË LEXIMIT TË KURANIT

109. Abdullah Ibën Shihhiri, radijallahu anhu, rrëfen: "Një herë erdha tek i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, dhe e gjeta në namaz. Prej të qarit, nga gjoksi, i dëgjohej fërshëllima ashtu siç vlon vorba." (Transmeton Ebu Davud)

110. Abdullah Ibën Mes'udi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Më lexo Kuran. - Si të të lexoj, o i Dërguari i Allahut - u përgjigja - kur Kurani të shpallet ty?- Unë dua ta dëgjoj prej dikujt tjetër. Fillova të lexoj suren En-Nisa, dhe kur lexova ajetin - "...e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata (që nuk besuan)?" (En-Nisa: 41), u ktheva dhe i pashë sytë e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, lotonin." (Transmetojnë Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Nesai)

SHTRATI

111. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: “Shtrati i të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, ku flinte ishte një lëkurë e regjur e mbushur me fije të palmës.” (Transmetojnë Muslim, Tirmidhi, Ebu Davud dhe Ibën Maxhe)

MODESTIA

112. Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Mos më ngritni tepër, ashtu si krishterët e ngritën Isaun, birin e Merjemit, sepse unë jam rob i Allahut, prandaj thoni: Rob dhe i Dërguar i Allahut.” (Transmetojnë Buhari dhe Ahmedi)

113. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: “Gjatë kryerjes së haxhxhit, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, kalëronte në samar të vjetruar, e në vete kishte një pelerinë të leshtë e cila nuk vlente as katër dërhemë. Thoshte: O Allahu im, bëre këtë haxh të pastër nga rijaja (puna për sy e faqe) dhe nga dëshira për fame (sum’a).” Transmeton Buhari dhe Ibën Maxhe. (Transmetojnë Buhari dhe Ibën Maxhe)

114. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ishte më i dashuri për shokët e tij. Kur e shihnin askush prej tyre nuk i çohej në këmbë, sepse e dinin se ai e urrente atë.” (Transmeton Buhari në Edebul-Mufred, Tirmidhi dhe Ebu Shejh)

115. Jahja ibën Ebi Hejthem El Attari thotë: E kam dëgjuar Jusuf Ibën Abdullah Ibën Selami, radijallahu anhuma, kur tregonte: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, më emërtoi Jusuf, më uli në prehër dhe ma ledhatoi kokën." (Transmeton Ahmedi)

116. Aisheja, radijallahu anha, është pyetur: "Ç'bënte në shtëpi i Dërguari, salallahu alejhi ue selem? -Ishte njeri i rëndomtë - u përgjigj - pastronte rrobat e veta, milte delen dhe kujdesej për vetveten." (Transmetojnë Buhari dhe Tirmidhi)

MORALI

117. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: "Isha shërbëtor i Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, dhjetë vite dhe asnjëherë nuk më tha as Uf dhe nuk më qortoi pse veprove kështu apo pse nuk veprove kështu. Ishte njeriu me moral më të lartë. Dora ime nuk ka prekur hazz e as mëndafsh më të butë se sa dora e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, era e djersës së tij, salallahu alejhi ue selem, ishte më e mirë se sa era e parfumit më të mirë." (Transmetojnë Buhari, Muslim, Tirmidhi dhe Ebu Davud)

118. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: "I Dërguari i Allahut, nuk ishte i paturpshëm, as që fliste fjalë të ndyta, as që bërtiste nëpër sheshe. Të keqen nuk e kthente me të keqe, por falte dhe ishte shpirtgjerë." (Transmeton Tirmidhi)

119. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, as që nuk e godiste me dorë përveç kur luftonte në rrugë të Allahut, nuk e godiste me dorë as shërbëtorin e as gruan." (Transmetojnë Muslim dhe Ahmedi)

120. Aisheja, radijallahu anha, tregon: "I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, i pranonte dhuratat dhe shpërblente për to." (Transmetojnë Buhari, Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ahmedi)

TURPI

121. Ebu Se'id Hudriu, radijallahu anhu, rrëfen: "I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ishte më i turpshëm se virgjëresha nën mbulesën e saj, kur diçka nuk i pëlqente, atë e vërenim nga fytyra e tij." (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Ibën Maxhe)

SI MJEKOHEJ I DËRGUARI ME HIXHAME

122. Aliu, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka bërë hixhame dhe e ka urdhëruar Aliun që ta paguan haxhxhamin. (Transmeton Ibën Maxhe)

123. Enesi, radijallahu anhu, thotë: "I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, bënte hixhamen në kapilarët e qafës dhe në pjesën e epërme në mes të shpinës, bënte hixhame ditën e shtatëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë dhe ditën e njëzet e njëjtë të muajit (hixhrij). (Transmeton Tirmidhi dhe Ibën Maxhe)

EMRAT E TË DËRGUARIT

124. Xhubejr Ibën Mut'imi, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Unë kam emra, unë jam Muhammedi, unë jam Ahmedi, unë Mahiu me të cilin Allahu fshin mosbesimin, unë jam Hashiri i cili do t'i tubon njerëzit ditën kur do të qëndrojnë para Allahut dhe unë jam Akibi pas të cilit nukka më të dërguar." (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

MOSHA E TË DËRGUARIT

125. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, rrëfen: "Të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, Shpallja i zbriste trembëdhjetë vjet në Mekke dhe dhjetë në Medine. Vdiq kur i pati gjashtëdhjetë e tre vjet." (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Tirmidhi)

126. Muavije, radijallahu anhu, tregon se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, Ebu Bekri dhe Omeri, radijallahu anhum, vdiqën kur i mbushën gjashtëdhjetë e tre vjet të jetës dhe unë tani i kam gjashtëdhjetë e tre vjet të jetës." (Transmeton Muslim)

VDEKJA E TË DËRGUARIT

127. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, tregon: “Për herë të fundit e pashë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, kur të hënën e zbuloi perden. Fytyra i shkëlqente sikur fleta e Mus’hafit. Ebu Bekri u printe njerëzve në namaz dhe njerëzit filluan të shqetësohen. Ai me dorë u dha shenjë që të qetësohen. Pastaj u lëshuan perdet dhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, vdiq kah fundi i asaj dite.” (Transmetojnë Buhari, Muslim, Nesai dhe Ibën Maxhe)

128. Aisheja, radijallahu anha, rrëfen: “I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ishte i mbështetur për gjoksin tim, kërkoi një legen për ta kryer nevojën. Pas kësaj shumë shpejt vdiq.” (Transmeton Nesai)

129. Aisheja, radijallahu anha, tregon: “Nuk kam lakmi për vdekje të lehtë, pasi që i pashë mundimet e vdekjes së të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem.” (Transmetojnë Tirmidhi dhe Nesai)

130. Aisheja, radijallahu anha, tregon: “Pasi që vdiq i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, erdhi Ebu Bekri, e puthi në ballë, e kapi për duar dhe tha: - Ah për Pejgamberin! Ah për të zgjedhurin! Ah, për shokun e jetës!” (Transmeton Tirmidhi në Shemail)

131. Aisheja, radijallahu anha, tregon: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, vdiq ditën e hënë.” (Transmeton Buhari)

132. Enes Ibën Maliku, radijallahu anhu, rrëfen: “Kur i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i ndjeu mundimet e vdekjes, Fatimeja, radijallahu anha, bërtiti: - Ah, për vuajtjet tua! I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, i tha asaj: - Prej sot babai yt më nuk do të ndjejë mundime. Babait tënd i ka ardhur ajo që do t’i vijë gjithkujt, takimi është në Ditën e Gjykimit.” (Transmetojnë Buhari, Nesai dhe Ibën Maxhe)

TRASHËGIMIA

133. Amër Ibën Harithi, radijallahu anhu, rrëfen: “I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, pas vetes la vetëm armën, mushkën dhe tokën të cilën e la vakëf.” (Transmetojnë Buhari dhe Nesai)

134. Aisheja, radijallahu anha, transmeton se i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Neve të dërguarve nuk na trashëgon askush. Gjithçka që mbetet pas nesh është sadaka.” (Transmetojnë Buhari dhe Muslim)

135. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon: “Trashëguesit e mi nuk do të ndajnë as dinar e as dirhem. Ajo që mbetet pas furnizimit për gratë e mia dhe punëtorët e mi është sadaka (lëmoshë).” (Transmetojnë Buhari, Muslim dhe Ebu Davud)